



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN
3 – MUJOR/NR.
KORRIK-SHTATOR
2008

BULETIN

Korrik – shtator 2008

PASQYRA E TITUJVE KRYESORË :

1. Monitorime
2. Të drejtat e shtetasve dhe rivendosja e tyre
3. Oponenca ligjore
4. Veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e diskriminimit
5. Veprimtari për rritjen e kapaciteteve të stafit të burgjeve
6. Tryeza dhe takime me përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve shtetërore dhe të organizatave ndërkombëtare
7. Ngritje kapacitetesh të stafit të KShH-së

Monitorim i dhomave të ndalimit dhe të shoqërimit në disa prej komisariateve të policisë

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëpërmjet korrespondentëve të tij, kreu disa vëzhgime në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit në komisaritet e qyteteve: Korçë, Fier, Shkodër dhe Elbasan.....

Vijon në faqen 2

Reforma në drejtësi dhe reforma zgjedhore në vëmendje të KShH-së.

Letër e hapur e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe e shoqatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve për reformën në drejtësi dhe letër e hapur e KShH-së për transparencën dhe gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit në hartimin dhe diskutimin e Kodit zgjedhor.....

vijon në faqen 3

Mbledhja e dytë e komitetit drejtues të projektit 'Drejtimi human i burgjeve'

Në datën 10 korrik 2008, në bashkëpunim me Agjencinë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Europian dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, KShH-ja organizoi mbledhjen e dytë të komiteti drejtues të projektit 'Drejtimi human i burgjeve'.

Vijon në faqen 4

Përgatiti buletin: Erida Skëndaj

Administratore zyre/

Aistente ligjore

Redaktimi letrar: Marie Mato

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. "Gjin Bue Shpata", pall. 5/1,
ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
Web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 22 33 671

Cel: 068 20 23 699;

E-mail: office@ahc.org.al

1. Monitorimi i respektimit të të drejtave të shtetasve

1.1 Monitorim i dhomave të ndalimit dhe të shoqërimit në disa prej komisariateve e policisë

Gjatë periudhës 29 shtator - 14 tetor 2008, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëpërmjet korrespondentëve të tij, kreu vëzhgime në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit në komisariatet e qyteteve: Korçë, Fier, Shkodër dhe Elbasan me qëllim vëzhgimin e respektimit të të drejtave të personave të ndaluar dhe të shoqëruar. Kushtet në dhomat shoqërimit dhe të ndalimit ishin nën standardet e kërkuara nga ligji.

Për problemet e konstatuara, nëpërmjet një letre drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, KShH-ja sugjeroi marrjen e masave konkrete për përmirësimin e kushteve në këto mjedise, si dhe bashkërendimin e punës së Policisë së Shtetit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për transferimin në kohë të personave të cilët kanë marrë masën e vlerësimit arrest në burg.

Misionet u mundësuan falë mbështetjes së dhënë nga Komiteti Suedez i Helsinkit

2. Të drejtat e shtetasve dhe rivendosja e të drejtave të shkelura

2.1 Qytetarët i adresohen KShH-së

Gjatë periudhës 1 korrik - 30 shtator 2008, KShH-ja ka marrë 63 ankesa nga persona të paraburgosur dhe të dënuar, nga shtetas që ankohen për marrëdhënie me administratën publike, për probleme pronësie, për procese të parregullta ligjore, për ushtrim dhune nga policia, për komunikimet me prokurorinë dhe për shërbim avokator falas. Krahas trajtimit të ankesave, KShH-ja ka ofruar këshillim ligjor për ankuesit dhe për shkeljet e konstatuara ka adresuar shqetësimet në organet kompetente.

Ky shërbim u mundësua falë mbështetjes së dhënë nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

2.2 Reagime publike për shkelje të të drejtave të shtetasve

Gjatë periudhës korrik-shtator 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka reaguar mes letrave të hapura dhe deklaratave publike në 6 raste, për çështje të tilla, si kërkesat e minatorëve për më shumë ndjeshmëri dhe transparencë ndaj tyre nga ana e qeverisë; për çështje që kanë të bëjnë me: nevojën për t'i dhënë fund cenimit të jetës private, reformën në drejtësi dhe nevojën e diskutimit dhe pjesëmarrjes në të të grupeve të interesit, lirinë e medias dhe presionin mbi televizionin NEWS 24, ecurinë e reformës zgjedhore dhe transparancën e saj.

Gjithashtu, në korrik të 2008-ës KShH-ja filloi zbatimin e projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, kujdesit shëndetësor dhe social në qendrat e fëmijëve». Për më shumë informacion klikoni në faqen tonë të internetit www@ahc.org.al

3.0 Oponenca ligjore

Gjatë periudhës korrik-shtator 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofroi ekspertizën e tij ligjore për projektligjet dhe projektregulloret e diskutuara në seancat dëgjimore parlamentare të organizuara në Kuvendin e Shqipërisë si dhe në tryezat e rrumbullakëta të organizuara nga shoqëria civile.

3.1 Projektregullorja e përgjithshme e burgjeve

Në kuadër të përmirësimit të respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar, mbështetjes së nismave për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe në veçanti me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe Rregullat Europiane të Burgjeve (REB), Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofroi mendime për projektin “Për Rregulloren e përgjithshme të burgjeve”. Mendimet dhe sugjerimet e tij iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë në muajin shtator 2008.

3.2 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Në kuadër të forcimit të pavarësisë së institucioneve kushtetuese dhe të organit të prokurorisë, duke vlerësuar pavarësinë e këtij institucioni, si një garanci më shumë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe një mjet më efektiv për të rivendesur në vend të drejtat e shkelura, KShH-ja, pasi u njoh me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9102, datë 10.7.2008, paraqiti disa mendime dhe sugjerime për përmirësimin e projektit të këtij ligji.

3.3 Reforma në drejtësi dhe reforma zgjedhore në vëmendje të KShH-së

Letër e hapur për reformën në drejtësi

Më 25 korrik 2008, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, së bashku me përfaqësues të Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatës Kombëtare të Prokurorëve dhe Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve, u mbledhën për të diskutuar ecurinë e reformës në sistemin e drejtësisë.

Në fund të takimit përfaqësuesit e këtyre organizatave dolën me një letër të hapur ku u evidentuan problemet parësore që ndikojnë negativisht në zhvillimin e kësaj reforme, si vonesa dhe copëzimi i saj. Gjithashtu, u dhanë edhe disa rekomandime përkatëse për përfshirjen e aktorëve të interesuar në hartimin e reformës (organizata të të drejtave të njeriut, organizatat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, ekspertë të pavarur të fushës) si dhe për nënshkrimin e ligjeve me rëndësi debatit të gjerë publik gjatë procesit të hartimit të projektligjeve. Për më shumë rreth përmbajtjes së letrës mund të lexoni www.ahc.org.al.

Letër e hapur për ecurinë e punës për reformën zgjedhore

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, më 16 shtator 2008 i drejtoi një letër të hapur z. Ilir Rusmajli dhe z. Fatmir Xhafa, dy bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, lidhur me ecurinë e punës për reformën zgjedhore.

Nëpërmjet kësaj letrë KShH-ja rishprehu shqetësimin e tij të thellë për vonesën e theksuar dhe të pajustificuar në hartimin e Kodit zgjedhor dhe parashtroi nevojën e transparencës së procesit, publikimit të dispozitave të shqyrtuara dhe të miratuara nga

Komisioni, si dhe nevojën e diskutimit publik dhe në grupet e interesit të projektligjit, para kalimit në Kuvend. Për më shumë rreth përmbajtjes së letrës mund të lexoni www.ahc.org.al.

3.4 Projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme »

Me kërkesë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ofroi opinionin e tij për projektligjin "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme » dhe mori pjesë në disa seanca të këtij komisioni.

Duke vlerësuar rëndësinë e projektligjit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të shtetasve dhe për të parandaluar dhe për të luftuar korrupsionin dhe veprimet arbitrare nga ana e policisë, KShH-ja sugjeroi që ky ligj të shihej në përputhje me ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", me Kodin e procedurës penale, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", ndryshuar në vitin 2004.

3.5 Në kuadër të fuqizimit të shoqërisë civile dhe mbështetjes së saj nga fondet e shtetit, KShH-ja ofroi mendime për projektligjin « Për fondin e zhvillimit të shoqërisë civile ». KShH-ja vlerëson nevojën e mbështetjes së sektorit të shoqërisë civile nga buxheti i shtetit.

4. Veprimtari trajnuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e diskriminimit

4.1 Parandalimi i diskriminimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla

Me synimin për të rritur kapacitetet profesionale të stafit pedagogjik që merret me edukimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë për parandalimin e sjelljeve diskriminuese të hapura dhe të fshehta, më 1 korrik 2008 KShH-ja organizoi një seminar trajnues me përfaqësues të drejtorisë arsimore, drejtues dhe mësues të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të rrethit të Fierit. Origjina, tradita, kultura, problemet e arsimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë, njohja me rekomandimet e Komisionit Europian kundër Racizimit dhe Intolerancës (ECRI) në këtë fushë ishin disa nga temat e trajtuara në këtë seminar.

Ky aktivitet u realizua me mbështetjen financiare të fondacionit *Soros*.

4.2 Punonjës policie më shumë të kualifikuar për parandalimin e diskriminimit në policim

Më 3 korrik 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale organizuan një trajnim të punonjësve të policisë së qarkut Fier, për çështjet e mosdiskriminimit.

Pjesëmarrësit u njohën me standardet dhe praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e parandalimit të diskriminimit nga ana e policisë, me traditat, kulturën dhe mënyrën e jetesës së komunitetit rom dhe atij egjiptian si dhe u informuan lidhur me kuadrin ligjor shqiptar dhe rekomandimin nr.11 të ECRI-t i cili i drejtohet policisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë kryesisht punonjës që janë në kontakt me publikun dhe me popullsinë romë dhe egjiptiane, **persona me qëndrim të parregullt**, punonjës që punojnë në dhomat e shoqërimit dhe të ndalimit, të sigurisë rrugore etj.

Ky aktivitet është realizuar falë mbështetjes financiare të fondacionit *Soros*.

4.3 Rritja e kapaciteteve të minoritetit rom dhe egjiptian për një përfaqësim më të mirë në vendimmarrjen vendore

Në datat 9 dhe 18 shtator 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale, organizuan trajnime të përfaqësuesve të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian në rrethet Elbasan dhe Korçë. Synimi i trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të komuniteteve romë dhe egjiptiane për një adresim më të mirë të shqetësimeve të tyre dhe mbrojtja e të drejtave pranë institucioneve vendore. Përfaqësuesit e minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian u informuan për funksionet e organeve të qeverisjes vendore, për mënyrat e komunikimit për adresimin e problemeve dhe nevojave të tyre si dhe për kuadrin ligjor kombëtar në këtë fushë.

Këto aktivitete u realizuan falë mbështetjes financiare të fondacionit *Soros*.

5.0 Veprimtari për rritjen e kapaciteteve të stafit të burgjeve

5.1 Vazhdon puna për hartimin e manualit për menaxhimin e burgjeve

Në datat 9-11 korrik 2008 KShH-ja organizoi një sesion pune për hartimin e manualit për menaxhimin e lartë të burgjeve. Specialistë shqiptarë dhe ndërkombëtarë punuan për të përfunduar versionin paraprak të këtij manuali.

Veprimtaria u organizua në kuadër të projektit 'Drejtimi human i burgjeve', mbështetur nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë, në kuadër të programit CARDS 2004.

5.2 Vazhdojnë trajnimet e personelit të përzgjedhur rishtas në institucionet penitenciare

Më datat 9-11 korrik 2008, 8-10 shtator 2008 dhe 24-26 shtator 2008 KShH-ja organizoi tri trajnime të punonjësve me uniformë të përzgjedhur rishtas në institucionin e Korçës. Trajnimet synuan rritjen e aftësive profesionale të personelit me uniformë të institucionit duke i pajisur ata me njohuritë bazë të funksionimit të burgut dhe të trajtimit njerëzor të personave të dënuar.

Disa nga temat e trajtuara ishin: sistemi penitenciar në Shqipëri, struktura organizative e një burgu, kujdesi për personelin, përzgjedhja dhe trajnimet bazë, aftësitë profesionale dhe qëndrimet ndaj të dënuarve, krijimi i një klime të sigurt, menaxhimi i konflikteve, diferencimi i të dënuarve, veprimtaritë ditore, Kodi i sjelljes, të dënuarit dhe kontaktet me botën jashtë, politikat disiplinore, kërkesë-ankesat etj. Rol i rëndësishëm në trajnim iu dha debatit në grup dhe mundësimi të vizitave në mjediset e brendshme të burgut. 86 punonjës me uniformë u trajnuan dhe u pajisën me certifikata. Ekspertët ndërkombëtarë dhanë kontributin e tyre në këto trajnime.

Veprimtaritë e mësipërme u organizuan në kuadër të projektit 'Drejtimi human i burgjeve', mbështetur nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë, në kuadër të programit CARDS 2004.

5.3 Mbledhja e dytë e komitetit drejtues të projektit 'Drejtimi human i burgjeve'

Në datën 10 korrik 2008, në bashkëpunim me Agjencinë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin Europian dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, KShH-ja organizoi mbledhjen e dytë të komitetit drejtues të projektit 'Drejtimi human i burgjeve'. Në këtë mbledhje u diskutuan ecuria dhe zbatimi i këtij projekti, arritjet, vështirësitë, sfidat e hasura gjatë zbatimit të tij dhe planet në vijimësi. Pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin përfaqësues nga organizata të tjera jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë, përfaqësues nga institucione shtetërore dhe nga misioni *Euralius*.

5.4 Takime me aktorë të ndryshëm që veprojnë në fushën penitenciare

Me synim bashkërendimin më të mirë të veprimtarisë së aktorëve që veprojnë në fushën penitenciare si dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme që prekin këtë fushë, gjatë periudhës korrik- shtator 2008 KShH-ja ka realizuar takime me përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, misionit *Euralius*, OSBE-së, PAMEC-ës dhe UNICEF-it.

Veprimtaritë e mësipërme u organizuan në kuadër të projektit 'Drejtimi human i burgjeve', mbështetur nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë, në kuadër të programit CARDS 2004 dhe projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet e paraburgimit dhe burgje", mbështetur nga UNICEF-i, Tiranë.

Në këto takime KShH-ja është përfaqësuar nga znj. Edlira Papavangjeli, menaxhere programi.

6. Tryeza dhe takime me përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare

6.1 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë

Më 18 korrik 2008, znj.Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, mori pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Në këtë takim ajo sugjeroi rishikimin e pikës 6 të nenit 2 të projektligjit « Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë » si dhe theksoi nevojën e përmirësimit të legjislacionit në këtë fushë në mënyrë që personat që bashkëpunojnë me drejtësinë, të përfshihen në programet e mbrojtjes.

6.2 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar lidhur me reformat ligjore

Më 30 korrik znj. Vasilika Hysi mori pjesë në mbledhjen e radhës së Konsorciumit Ndërkombëtar për: seancat dëgjimore në gjykatën e shkallës së parë, Tiranë dhe në gjykatën e apelit; azhurnimin e ligjit të ri për mbrojtjen e dëshmitarëve ; transparencën e reformës gjyqësore dhe përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile në këtë proces si dhe për diskutimin e reformës së propozuar në Kodin e procedurës penale. Znj.Hysi shprehu shqetësimin se shumë prej projektligjeve miratohen pa u konsultuar gjerësisht me grupet e interesit. Gjithashtu, ajo solli në vëmendje të pjesëmarrësve shqetësimin e organizatave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe të vetë KShH-së për transparencën e reformës në drejtësi.

6.3 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e Grupit të Punës për Çështjet e Trajnimeve dhe të Asistencës në Pajisje për Policinë Shqiptare të Konsorciumit Ndërkombëtar

Në datën 4 shtator 2008 znj. Ersida Sefa, koordinatorë projekti, mori pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar, konkretisht të Grupit të Punës për Çështjet e Trajnimeve dhe Asistencës në Pajisje për Policinë Shqiptare dhe prezantoi nismën e ndërmarrë në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë në qarkun e Fierit, Elbasanit dhe Korçës lidhur me çështjet e parandalimit të diskriminimit të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian dhe zbatimin e rekomandimit 11 të ECRI-t “Për parandalimin e diskriminimit në policim”.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe pjesëmarrësit në këto aktivitete kanë shprehur interes për përmirësimin e kapaciteteve të tyre profesionale në fushën e të drejtave të njeriut dhe të praktikave diskriminuese.

6.4 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e komisionit të ngritur nga Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në Ministrinë e Jashtme, për zbatimin e rekomandimeve të ECRI-t

Në datën 22 shtator 2008 znj. Ersida Sefa mori pjesë në mbledhjen e radhës të grupit për zbatimin e rekomandimeve të ECRI-t ku paraqiti nismën e KShH-së në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet organeve të qeverisjes vendore me përfaqësuesit e minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian. Nisma e KShH-së është në zbatim të rekomandimeve të ECRI-t për përmirësimin e kapaciteteve profesionale të minoritetit rom dhe pjesëmarrjen e tyre në administratë dhe vendimmarrje. Gjithashtu, në këtë mbledhje KShH-ja prezantoi disa shqetësime të evidentuara nga përfaqësuesit e minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian gjatë takimeve të kryera nga ky komitet në nivel vendor.

6.5 KShH-ja merr pjesë në mbledhjen e komisionit të ngritur nga Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në Ministrinë e Jashtme, për zbatimin e rekomandimeve të CPT-së

Më 23 shtator 2008 znj. Etilda Saliu, koordinatorë e klinikës ligjore në KShH, mori pjesë në mbledhjen e organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në Ministrinë e Punëve të Jashtme ku u diskutua raporti i fundit i Komitetit për Parandalimin e Torturës. Raporti pasqyrore konstatimet e vërejtura nga CPT-ja nga monitorimet e bëra nga institucionet

e vuajtjes së dënimit, paraburgimit, komisariateve dhe spitaleve në Shqipëri. Përfaqësuesja e KShH-së paraqiti gjendjen e të drejtave të njeriut në disa institucione penitenciare të monitorura nga KShH-ja dhe bëri disa rekomandime për përmirësimin e situatës në këtë fushë.

6.6 KShH-ja merr pjesë në konferencën kombëtare për konsolidimin e bashkëveprimit mes pushtetit vendor dhe atij qendror

Më 4 shtator 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit mori pjesë në konferencën kombëtare me temë “Drejt një bashkëveprimi të konsoliduar mes pushtetit vendor dhe institucioneve qendrore në nivel vendor”.

Gjatë diskutimit, znj. Erida Skëndaj, juriste, i njohu pjesëmarrësit me problemet e vërejtura në këtë fushë nga KShH-ja dhe paraqiti disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes në fushën përkatëse.

Konferenca u zhvillua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe IDRA.

6.7 Konferencë për shtyp për respektimin e kuotës gjinore

Në kuadër të angazhimit në fushatën për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje si dhe duke marrë shkas nga niveli i ulët i përfaqësimit të grave në jetën politike, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, së bashku me përfaqësues të lëvizjes së gruas, shoqërisë civile dhe botës akademike, më 25 shtator 2008 organizuan një konferencë për shtyp.

Konferenca u organizua në vazhden e përpjekjeve për përmirësimin e statusit politik të gruas shqiptare duke i kërkuar Kuvendit të Shqipërisë dhe forcave politike angazhimin e tyre në mbështetjen reale të kuotës gjinore, si element i rëndësishëm për promovimin e balancës gjinore në Shqipëri. Në fund të konferencës pjesëmarrësit hartuan një deklaratë lidhur me kërkesat e tyre për një respektim më të mirë dhe zbatim në praktikë të kuotës gjinore të afirmuar në ligjin “Për barazinë gjinore”.

7 Ngritje kapacitetesh të stafit të KShH-së

7.1 KShH-ja merr pjesë në trajnimin “Për procedurat e brendshme organizative të organizatave”

Në datat 10-11 shtator 2008 KShH-ja mori pjesë në trajnimin “Për procedurat e brendshme organizative të organizatave”, organizuar nga Partners Albania. Trajnimi solli disa modele të mira praktike dhe funksionale të organizimit të brendshëm procedural të OJF-ve. Gjithashtu, trajnimi shërbeu si një shkëmbim përvojash mes organizatave pjesëmarrëse, ku secili prej pjesëmarrësve solli modelin e brendshëm organizativ procedural të organizatës që përfaqësonte.

Përfaqësuese e KShH-së në këtë trajnim ishte znj. Erida Skëndaj, administratore zyre dhe asistente ligjore.